



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

NJOFTIM PËR SHTYP

**MBI DHËNIEN ME KONCENSION TË FORMËS R.O.O.T, PËR REHABILITIMIN
DHE VËNIEN NË PUNË TË TERMOCENTRALIT VLORË SI DHE NDERTIMIN E
TUBACIONIT FIER-VLORË PËR FURNIZIMIN ME GAZ TË KËTIJ TEC-I**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur të implementojë projektin e rehabilitimit dhe të operimit të Termocentralit të Vlorës (TEC), pranë bregut të detit Adriatik, 6 km nga qyteti i Vlorës (Shqipëri), duke përfshirë mundësisht një degëzim të tubacionit të gazit Fier-Vlorë. Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet bazuar në një procedurë të hapur konkurrimi, sipas kritereve specifike të kualifikimit dhe vlerësimit që ndodhen në dokumentet standarde të procedurës.

Përshkrim i shkurtër i koncensionit/kontratës së partneritetit privat-publik

1. Objekti i kontratës: Rehabilitimi dhe Vënia në Punë e Termocentralit të Vlorë-s si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të tij
2. Lloji i kontratës: R.O.O.T (Rehabilitate – Own – Operate – Transfer)
3. Burimi i financimit: Kompani private tregtare / Kapital privat
4. Vlera e parashikuar e projektit, sipas studimit të fizibilitetit është 58,719,958 Euro.
5. Kohëzgjatja e kontratës konçesionare/PPP është 20 vjet.

MIE do të organizojë një vizitë në terren me date 15 Janar 2019, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të marrin informacionin e nevojshëm. Pjesëmarrja në këtë vizitë është e detyrueshme. Pjesëmarrësit në këtë vizitë do të takohen në ora 12:00 në vendndodhje, me adresë:

TEC Vlorë Rruga e Pishave, Vlorë 9400. Personi i kontaktit dhe përgjegjës do të jetë znj. Etleva Kondi, me adresë të postës elektronike: etleva.kondi@infrastruktura.gov.al.

Gjatë vizitës në terren, kompanitë/OE që do të marrin pjesë në këtë vizitë, do të kenë akses në dhomën e të dhënave elektronike (Data-Room) duke nënshkruar një deklaratë kofidencialiteti për ruajtjen e këtyre të dhënave, si dhe do të pajisen me certifikatë pjesëmarrje, e detyrueshme për t'u paraqitur si pjesë e ofertës.